

PETROS MARKARIS
LËVIZJA E VETËVRASJES
ROMAN POLICOR

BOTIMET TOENA

PETROS MARKARIS

LËVIZJA E VETËVRASJES

roman policor

Përktheu nga origjinali greqisht Kristo Pulla

BOTIMET TOENA

Tiranë

Autori: Πέτρος Μάρκαρης (Petros Markaris)
Titulli në origjinal: Το κίνημα τις αφοκτονίας
Botoi në greqisht: εκδόσεις KEIMENA



Ky botim u përgatit nën kujdesin
e Ambasadës së Greqisë në Shqipëri.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Redaktore: Albina Pulla
Korrektore letrare: Sonila Kryeziu
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376985

© 2022 nga Petros Markaris dhe Diogenes Verlag AG, Cypri.
Të gjitha të drejtat përveç atyre greke janë të rezervuara.

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë
lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit
të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Në kujtim të Andrea Camilleri-t

“Po plakem, gjithmonë duke mësuar shumë gjëra.”

Soloni

Vizitat e mëngjesit më krijojnë një ndjesi të pakëndshme. Për fat të mirë, Stela nuk futet në kategorinë e vizitorëve. - Mori në telefon njëfarë Vllasopullos dhe dëshiron të flasë me ju. Më tha që e njihni. - Ajo lexon surprizën në fytyrën time dhe pyet për t'u siguruar: - E njihni?

- Sigurisht, ashtu siç e njihni dhe ju. Në të kaluarën ka shërbyer në Sektorin e Vrasjeve. Ndoshta nuk ia dije emrin, por me siguri që e ke parë duke më shoqëruar në zyrën e Gjiksës. - Ia përshkruaj Vllasopullon dhe asaj i vjen menjëherë ndër mend.

- Posi jo, e mbaj mend! Po shkoj ta thërras.

Do të gënjeja, nëse do të thosha që isha i entuziazmuar. Vllasopullosi kishte qenë vartësi im për shumë vite me radhë, por u ndamë në kushte aspak të këndshme. Në kohën kur ish-zëvendës drejtori i përgjithshëm ma kishte nxirë jetën, Vllasopullosi u rreshtua krah tij, me shpresën se në këtë mënyrë do të ngjiste shkallët e karrierës. Por planet nuk i ecën dhe u detyrua të kërkonte transferim, sepse ishte e pamundur tashmë të bashkekzistonim në të njëjtin institucion. Që atëherë nuk kishim asnjë kontakt dhe pyesja veten se si duhej të sillesha me të.

Zilja e telefonit ndërpret mendimet e mia. - Mirëdita, zoti nëndrejtor! Më mbani mend? - më pyet me një zë që dëgjohet i përzemërt.

- Sigurisht që ju mbaj mend, Vllasopullos. E si mund t'ju harroja pas kaq vitesh në të njëjtin institucion? - i përgjigjem duke u munduar t'ia kthej po me përzemërsi.

Vijojnë pyetjet formale për shëndetin, dhe për shëndetin e dy familjeve në kushtet e pandemisë, derisa, më në fund, futemi në temë.

- Jam shefi i komisariatit në "Egaleo". Ju telefonova për të kërkuar mendimin tuaj. Dje në lagje vrau veten një qytetar, që quhej Dhimitër Begleri. Ishte rreth të nëntëdhjetave. Ne e mësuam krejt rastësisht sot në mëngjes. Mjeku që shkoi për të konfirmuar vdekjen e tij, e pa të udhës se duhej të na dërgonte letrën që i ndjeri la për arsytet e vetëvrasjes së tij.

- Letra përmban diçka që ju ngjalli dyshime?

- Poshtë firmës së tij ka shtuar një frazë: "Rroftë lëvizja e vetëvrasjes". Më lindën dyshime dhe mendova t'ju vija në dijeni.

- Ka ndonjë deklaratë tjetër apo ndonjë frazë me nënkuptime në letër?

- Jo. Bën një përshkrim të situatës së sterrosur përreth tij, për të shpjeguar vendimin e tij për t'u vetëvuarë. Vetëm kaq.

- Në çfarë mënyre e vrau veten?

- Mbesa e tij, që i çoi ushqimin në darkë, e gjeti në krevat me një thikë pranë. Kishte prerë damarët.

- Atëherë, ajo fraza në fund, nuk përjashtohet të jetë një britmë dëshpërimi.

- Po, nuk përjashtohet, - bie dakord Vllasopullosi.

Preferoj të mos i ul menjëherë qepenat, tani që kontaktet tona u rivendosën. - Më dërgoni letrën e të vetëvrarit, që ta lexoj, dhe flasim përsëri.

- Po jua dërgoj në mënyrë elektronike, - më përgjigjet, dhe e mbyllim bisedën.

Çfarëdo që të bëjmë, pandemia na mban në gjendje të vazhdueshme tensioni, kurse tani, me *lockdown*-in e përgjithshëm, ajo sjell edhe mbingarkesa shtesë, që të kujtojnë tatimet e jashtëzakonshme.

Madje, edhe jeta jonë familjare është një sprovë e vazhdueshme nervash të tendosura. Fani ia ka ndaluar Melpos të kujdeset për Llambron, nga frika se mos sjell virusin nga qendra e të pastrehëve ku qëndron, megjithëse Zisi u bën çdo javë teste të pastrehëve që nuk janë vaksinuar ende. Adriana ka marrë përsipër përkujdesjen për nipin gjatë gjithë ditës.

Ndërkohë, më shumë se Llambroja, ia ngrenë nervat prindërit e tij. Katerina përpiqet t'i menaxhojë punët e saj në mënyrë elektronike ose me telefon, por gjykatat janë pezulluar dhe pothuajse asnjë çështje nuk po përparon. Tensioni i madh në spital e ka rraskapitur Fanin fizikisht dhe shpirtërisht. Kur kthehet në shtëpi nuk ka dëshirë të hapë gojën as për të ngrënë. Mezi ia del të mbajë pak në prehër të birin. Situata mes çiftit është vazhdimisht e tensionuar.

Për fat të mirë, Adriana, Fani dhe unë tashmë jemi vaksinuar. Vetëm Katerina është në pritje.

Unë jam më i qeti në familje. Në institucionin ku punoj, mbretëron një qetësi absolute; i ngjan periudhës kur vera

është në kulmin e saj dhe nuk lëviz as gjethja. Siç duket, *lockdown*-i i detyroi edhe vrasësit të mbyllën në shtëpitë e tyre. Si po shkojnë gjërat, pas pak do të fillojmë të luajmë tavllë dhe lojëra me letra, që të kalojmë kohën gjatë shërbimit.

Çdo natë marr rrugën për te shtëpia e vajzës sime, me shpresën se do t'ia dal të ngre disi moralin e familjes.

Ia filloj me nipin, që më pret sikur të isha Miushi Miki. Luajmë bashkë derisa i vjen ora për të ngrënë e për gjumë. Pastaj i vjen radha treshes familjare. Përpiqem ta qetësoj disi atmosferën, sepse tensioni i përditshëm, me pretekstin më të vogël, përfundon në të bërtitura dhe shpërthime zemërimi.

Këtë program të përditshëm e ndjek me devocion dhe pa përjashtime. Adriana madje është kujdesur të më sjellë rroba nga shtëpia, që të ndërrohem e të mos vij rrotull nëpër shtëpi me rrobat e shërbimit.

Qershia mbi tortë është mungesa e Zisit. Megjithëse është vaksinuar, nuk largohet për asnjë moment nga qendra e të pastrehëve. Nga njëra anë, sepse me këtë situatë të vështirë synon të ketë nën mbikëqyrje të përditshme funksionimin e qendrës dhe, nga ana tjetër, sepse përpiqet t'u paraprijë mashtrimeve dhe sjelljeve tinëzare të disa të pastrehëve. Atij nuk i ndahet frika se mos gjatë mungesës së tij disa prej të pastrehëve mund të largohen dhe të kthehen në strehë bashkë me virusin. Të gjitha këto e detyruan Zisin të zbatojë një karantinë formale.

Stela më ndërpret mendimet duke më lexuar letrën e të vetëvrarit. Është e shkruar me shkrim dore.

Jam 90 vjeç. Fillova të punoj në ndërtim, në sheshin “Koxia” dhe ia dola të kem një shtëpi timen. Një jetë të tërë përpjekjesh dhe luftime të përditshme. Sot vështroj përreth meje dhe lufta e përpjekjet janë bërë si pjesët e përhershme 45-minutëshe të lojës së futbollit. Nga pandemia po e pësojnë dyqanet, kafenetë dhe tavernat. Të gjitha qëndrojnë të mbyllura. Të gjithë po humbasin bukën e gojës, por askush nuk po del të protestojë. Në kohën time do të kishim shpikur njëqind mënyra për të protestuar. Edhe nëse do të qëndronim para dyerve të dyqanit të mbyllur, me një pankartë ku të shkruhej: “Jemi të uritur”, prapë protestë do të quhej. Ne nuk kishim asnjë qindarkë, kurse të sotmit i harxhuan paratë e tyre për gjëra gjoja madhështore, por që rezultuan të rreme. Shoh në televizor sesi jemi katandisur dhe kjo po më ha përbrenda. Fillimisht humba gruan, pastaj dhe vajzën time. Më ka mbetur vetëm mbesa, Jana, që më sjell përditë një pjatë me gjellë dhe shkëmben dy fjalë me mua. Më mirë të mbyll sytë dhe të bie rehat. Mundet që, nëse i jap fund jetës sime, disa të zgjohen dhe të fillojnë të luftojnë.

Jana ime, është koha të shkoj. Mos u pikëllo që po më humbet. Mendo se do të jem më mirë. Të uroj shëndet.

*Dhimos Begleri
Rroftë lëvizja e vetëvrasjes.*

E lexova letrën dy herë, por nuk gjeta diçka të dyshimtë apo të çuditshme. Një burrë në moshën nëntëdhjetëvjeçare,

që humbi gruan, vajzën dhe jeton vetëm, vendos t'i japë fund jetës së tij. Ato të tjerat mbi shpirtin luftarak, nuk janë gjë tjetër veçse një mënyrë për ta nxirë akoma më shumë realitetin e zymtë dhe për të lehtësuar vendimin që mori.

Por ndërkohë nuk dëshiroj të kufizohem në konkluzionin tim, nga frika se mos më ka shpëtuar diçka. Thërras grupin e bashkëpunëtorëve të mi dhe u jap për të lexuar letrën e lamtumirës që kishte shkruar Begleri. Kur mbarojnë, të gjithë më vështojnë shumë të habitur.

- Ku e shihni problemin? - më pyet me habi Dermixaki.

I përcjell mendimin që shfaq Vllasopullosi. Kur dëgjuan emrin e tij, Kulla dhe Dermixaki mbetën gojëhapur.

- Ku është tani? - më pyet Kulla.

- Shef komisarati në "Egaleo".

- E përse i lindën këto dyshime? - vazhdon të pyesë i habitur Dermixaki.

- Frazja e fundit me atë "rroftë" i ngjalli dyshime.

- Mos bëni kështu. Presim të arsyetojë dikush që bëhet gati të vrasë veten? - shfaq mendimin e tij Dervisogllu.

Diskutimi mbyllet me një konkluzion të njëzëshëm. Marr menjëherë në telefon Vllasopullon. - Të gjithë në sektor jemi të një mendjeje se kemi të bëjmë me një thirrje dëshpërimi të Beglerit para se t'i japë fund jetës, - i them.

- Në rregull. Atëherë mund të jem i sigurt se nuk më ka shpëtuar diçka.

E mbylлим me të falat që i dërguan Dermixaki dhe Kulla. Vllasopullosi më premtun se do të na vizitojë në rastin më të parë.

Në të kaluarën, kur donim të theksonim rutinën e përditshme, thoshim: “Asgjë e re nga Fronti i Perëndimit”. Kjo ndryshoi me koronavirusin. Tani themi: “Çdo ditë e djeshme ishte më e mirë”, në vend të “çdo vit i vjetshëm dhe më mirë”, përderisa nga dita në ditë po shkojmë keq e më keq.

Por në shtëpinë e vajzës sime, ama, vlen thënia “një nga të zakonshmet”. Çdo natë shpresoj për ndonjë surprizë, por rutina arrin ta përthithë: nervozizmi i Fanit, që kthehet i rraskapitur nga spitali, dhe sforcimi i tepërt i vajzës së tij, nga kalvari në punën e saj.

Viktima e parë e kësaj sprove është djali i tyre. I kthehen atij për çdo çapkënllek që mund të bëjë, dhe Llambroja ia shkrep të qarit. Mbrojtësja e vetme që ka vogëlushi është gjyshja e tij, e cila e çon menjëherë në dhomën e tij, duke kërkuar mënyra për ta qetësuar.

Me këto mendime në kokë i bie ziles së Katerinës. Derën ma hap Adriana, me Llambbron në krahë.

- Gjyshi! Erdhi gjyshi, - i thotë e gëzuar nipit tonë dhe e tund duke e mbajtur në krahë.

Shprehja në fytyrën e saj me paralajmëron për “një nga të zakonshmet”.

Ndërroj rrobat dhe shkoj te dhoma e nipit. E marr në krahë dhe Llambroja shfaq menjëherë gëzimin për takimin tonë.

E vendos në dysheme dhe filloj t’i montoj atë trenin e tij të vogël, vagonët e të cilit janë shpërndarë gjithandej. Ky tren i vogël është dobësia e tij. Sapo e sheh që lëviz mbi shina, fillon të qeshë dhe të përplasë pëllëmbët. Të njëjtën gjë bën edhe tani, ndërkohë që unë imitoj sirenën e trenit.

- U grindën përsëri? - pyes Adrianën, sapo Llambroja i përkushtohet trenit të tij.

Ajo hap duart e dëshpëruar. - Si ka mundësi që një çift kaq i dashuruar, me një jetë kaq harmonike, arrin të grindet përditë?! Për mua kjo përbën mister.

Treni është ndalur dhe Llambroja fillon të bërtasë. Unë i kurdis zemberekun, që të fillojë të lëvizë përsëri. Në atë moment vjen Katerina.

- Mirëmbërëma, babi! - më thotë me një ton të prerë dhe i kthehet nënës së saj. - Ushqimi për Llambbron është gati. Do ta ushqesh apo ta ushqej unë?

- Ushqeje ti, unë do të merrem me përgatitjen e darkës.

Zhvendosemi të gjithë në dhomën e ndenjjes. Tavolina ndërkohë është e shtruar për Llambbron dhe ushqimi i tij është gati. Katerina e ul dhe fillon ta ushqejë.

Fani, sapo hyn, drejtohet nga i biri, e përqafton butësisht te shpatullat dhe e puth. Pastaj largohet dhe e lë veten të plasat në një kolltuk. Duket i raskapitur. Nëse raskapitja është trupore apo shpirtërore, këtë nuk e di. Ndoshta janë të dyja bashkë.

Nuk dua të hap bisedë për sa kohë ushqehet vogëlushi, se kam frikë mos trembet nga ndonjë shpërthim zemërimi dhe ia largon oreksin. Për fat të mirë, vjen Adriana dhe fillon të shtrojë tavolinën.

- Hajde tani, thuaj “natën e mirë” dhe shkojmë për të fjetur, - i thotë Katerina vogëlushit teksa e merr në krahë. Llambroja merr të puthura nga secili prej nesh dhe largohet.

Mbetemi që të tre pa folur. Fani nuk ka dëshirë të flasë, dhe ne, burrë e grua, nuk dimë çfarë të themi. Adriana mbaron me shtrimin e tavolinës dhe sjell ushqimin. Ka përgatitur mish qengji frikase. Presim Katerinën, që të ulemi në tavolinë.

Adriana shërben pjatat, por thyen heshtjen para se të fillojmë për të ngrënë. - Dua të sqaroj diçka, tani që është edhe Kosta këtu. Nëse keni ndër mend të vazhdoni me zënkat tuaja të përditshme, atëherë na lejoni ta marrim ne fëmijën në shtëpi. Është bërë nevrík edhe ai vogëlush kaq i qetë, shpërthen vazhdimisht në britma dhe të qara. Nëse vazhdoni me këtë avaz, kam shumë frikë se kur të rritet do të shfaqë probleme psikologjike.

Prindërit vështrojnë pjatat e tyre dhe nuk ndihen. Adriana hedh një vështrim drejt meje, thua se po më kërkon të marr stafetën.

- Jeni një çift kaq i qetë. Çfarë ju ka kapur papritur, që shpërtheni ndaj njëri-tjetrit? - i pyes.

Fani ngre vështrimin nga pjata dhe e drejton nga unë. - Ti je polic. Ke dëgjuar ndonjëherë për tejkalim të caqeve njerëzore?

- Në kam dëgjuar po më pyet? Ka qenë stimuli, shkëndija e të paktën gjysmës së numrit të vrasjeve me të cilat jam marrë.

- Pikërisht këtë gjë pësuam Katerina dhe unë. Kemi tejkaluar caqet tona. Unë në spital, i cili rrezikon “të ngrejë duart përpjjetë”. Ia kemi kushtuar të gjitha energjitë tona koronavirusit, por ka edhe sëmundje të tjera shumë serioze. Çdo ditë e re është më e keqe se dita paraardhëse dhe nuk e dimë nëse dhe kur do të kthehemi përsëri në normalitet. Kur kthehem në shtëpi, i kam kaluar caqet e mia, mundësitë e mia dhe kërkoj vetëm një shkas që të shpërthej.

Ai hesht, ndërkohë që unë i kthehem sime bije. - Po ti, pse kaq e tensionuar?

Katerina bën së pari një përpjekje për të ruajtur gjakftohtësinë. - Babi, ti ke një post të përhershëm në polici dhe një pagë fikse. Vendose veten në vendin tim. Gjykatat nuk po funksionojnë dhe shumica e klientëve të mi ose i mbyllën bizneset e tyre, ose mbetën pa një dyshkë. Megjithëse e ndajmë përgjysmë qiranë e zyrës me Manjën, duhet që çdo muaj të paguajmë, përveç qirasë, edhe një sekretare, pa llogaritur këtu faktin që nuk po sjell asnjë qindarkë në shtëpi. Dhe të gjitha këto, pa pasur idenë se kur do të funksionojë përsëri normalisht zyra ime dhe kur do të jem në gjendje t’u përgjigjem detyrimeve të mia profesionale dhe familjare. Kështu që po të pyes: a mund të jem e qetë?

- Po sot përse u grindët, për shkak të spitalit apo të zyrës së avokatisë? - Fani me Katerinën vështrojnë njëri-tjetrin të pavendosur dhe befas shpërthejnë në të qeshura.

- Për shkak të vetëvrasjes, - më thotë Fani dhe vazhdon të qeshë.

- Vetëvrasjes? - Pyes veten nëse e kisha dëgjuar mirë.

- Do të ta shpjegojë Katerina.

- Teksa punoja në kompjuter, hapa *Facebook*-un dhe ndesha rastësisht në postimin e letrës së një plaku nëntëdhjetëvjeçar, që kishte vlarë veten. Befas më ndizet sinjali i alarmit, por u përmbajta që të mos e ndërpres. I vetëvrari thoshte në letër se ishte munduar gjithë jetën dhe se sot i dhimbsej teksa nuk shihte njeri të ngrihej dhe të protestonte. Dhe përfundonte duke thënë se preferon të vdesë me shpresën se, me vdekjen e tij, disa do të zgjohen. - Bën një pauzë dhe merr frymë thellë. - Kur ia tregova Fanit, ai filloi të bërtasë. Më tha se ditët e një nëntëdhjetëvjeçari, sido që ta marrësh, janë të numëruara. Por nëse me letrën që ai la, disa do të ngrihen, e sigurt është që do të kemi shtim të numrit të rasteve me *covid* dhe sistemi shëndetësor nuk do të jetë në gjendje ta përballojë. Unë e akuzova për pandjeshmëri dhe kështu filloi zënka. - Pushon, shtrëngon kokën me të dyja duart dhe buzëqesh.

- Mos ndoshta emri i të vetëvرارit ishte Dhimosten? - e pyes unë. Tri palë sy kthehen të habitur nga unë dhe më vështrojnë.

- Besoj se po, - më përgjigjet Katerina. Nxjerr nga xhepi telefonin celular dhe fillon të kërkohet. - Po... Dhimosten Begleri... - më thotë pas pak.

- Dhe letra mbyllet me frazën: “Rroftë lëvizja e vetëvrasjes”?

- Po ti, nga i di këto? - më pyet Adriana, që kishte mbetur pa fjalë.

- Ma dërgoi letrën një koleg i vjetër. Lexoi frazën e fundit dhe më mori për të kërkuar mendimin tim.

- Po ti, çfarë mendon? - më pyet vajza ime.

- Asgjë. E diskutuam në punë dhe arritëm në konkluzionin se nuk është gjë tjetër, përveçse një britmë dëshpërimi.

- Për më tepër, edhe vetëvrasja është një tejkallim caqesh dhe mundësish, - shton nga ana e vet Fani.

Adriana zë e bën kryqin. - Zoti vëntë dorë, se nuk e dimë çfarë na pret tjetër! - thotë ajo.

- Adriana ka të drejtë. Pikërisht ngaqë nuk e dimë se çfarë tjetër na pret, kemi nevojë për gjakftohtësi dhe t'i qëndrojmë në krah njëri-tjetrit.

Pjesa tjetër e darkës rrjedh normalisht, me biseda në tone të qeta, por mendja ime punon gjetiu, te përhapja e asaj letre nëpërmjet rrjeteve sociale. Ndoshta e postoi e mbesa në rrjetet sociale dhe që andej filloi përhapja.

- Gjendja duket sikur u qetësua disi, - i them Adrianës rrugës për në shtëpi.

- Ashtu qoftë! Uroj të mos kujtojmë atë thënien "mrekullia tri ditë zgjat", - më përgjigjet ajo dhe vazhdon. - Nuk e merr me mend se çfarë ankthi është të presësh të kthehet Fani dhe të fillojnë zënkat. Këtu jam bërë unë me nerva, si mund të durojë një foshnjë dy vjeç?

Arrijmë në shtëpi dhe i hedh një sy orës. Pas çerek ore fillon emisioni i lajmeve të mbrëmjes dhe vendos ta ndjek. Përhapja e letrës së Beglerit më ka shkaktuar një shqetësim që nuk mund ta shpjegoj. Preferoj të dëgjoj lajmet e fundit,

në mënyrë që, nëse ka rezultuar ndonjë zhvillim i ri, të jem në dijeni.

- Do të rri të ndjek lajmet, - i them.

Më vështron me habi të madhe. - Dozën time nga terri i koronavirusit për sonte e kam marrë të plotë, nuk më duhet dozë tjetër, - më përgjigjet dhe i drejtohet dhomës së gjumit.

Kur fillon emisioni i lajmeve, e përgëzoj veten për parashikimin e saktë. Letra është lajmi i dytë, menjëherë pas lajmeve për koronavirusin. E kishin shfaqur madje dhe në ekran, thua se kanë mbetur akoma persona që nuk e kanë lexuar në rrjetet sociale.

Tani së fundmi është bërë e modës të ftojnë një ekspert për çdo temë, duke u ofruar ndjekësve një analizë të thelluar. Për rastin e Beglerit, i ftuar ishte një psikiatër, i cili jep një sërë shpjegimesh dhe sjell argumentet respektive. Gjithçka përfundon te një fjalë e vetme, që e përmendëm dhe në tavolinë: zhgënjim.

Por surpriza ndërkohë ishte lënë për në fund, dhe ajo nuk është e këndshme as për policinë dhe as për mjekët.

Shoqatat e tregtarëve njoftuan se të nesërmen do të organizonin manifestime proteste kundër *lockdown*-it. Sado që duket e pabesueshme, i them vetes sime, Begleri i mobilizoi me vetëvrasjen.

Mbyll televizorin dhe shkoj në banjë për t'u zhveshur. Futem në dhomën e gjumit, Adriana ka kohë që bën një gjumë të thellë.

Ndodh shpesh që kafja më ftohet për shkak të një mbledhjeje apo të një hetimi urgjent, por të mos më dalë koha të prek filxhanin ngaqë u vetëvra një i moshuar, më ndodh për herë të parë. Sapo futem në zyrën e Stelës, me kafënë në dorë, gjej aty Allamanon, komandantin e njësisë speciale MAT, i cili po më priste.

- Kam ardhur t'ju informoj për një manifestim që do të zhvillohet sot, - më raporton i qetë dhe duke buzëqeshur teksa futemi në zyrën time.

- E dëgjova mbrëmë në darkë te lajmet. Mos ndoshta e dini se ku do të zhvillohet?

Allamanos më hedh një vështrim. - Këtu qëndron problemi.

- Domethënë?

- Njëkëtë moment që po flasim, nuk kemi asnjë informacion për vendin dhe orën e zhvillimit të manifestimit. Sigurisht, kur grumbullimet ndalohen për shkak të epidemisë, ata nuk janë të çmendur të na informojnë, që ne t'i shpërndajmë pa arritur akoma të mblidhen.

- E si t'ia bëjmë?

- Vendosëm të dërgojmë njësitë tona në dy sheshe, ku bëhen zakonisht manifestimet, në sheshin “Sintagma” dhe në sheshin “Omonia”, dhe të kemi patrulla vëzhgimi në sheshet “Viktoria” dhe “Koxia”. Është e vetmja gjë që mund të bëjmë tani për tani.

Arsyetimi i tij është i drejtë dhe nuk kam diçka për të shtuar. - Kërkoj të më mbash të informuar vazhdimisht, - i them komandantit.

- Mos u shqetëso. Do të jemi vazhdimisht në kontakt.

Allamanosi largohet dhe unë marr menjëherë në telefon Vllasopullon. - I ke ndjekur zhvillimet apo dëshiron të të informoj? - e pyes.

- Mos u lodhni. I pashë dhe i lexova të gjitha.

- Bukur. Atëherë, dua të komunikosh me mbesën e Beglerit dhe të verifikosh nëse e postoi ajo letrën e gjyshit të saj në rrjetet sociale, apo nëse ia ka dhënë dikujt tjetër dhe kush është ky person.

- Ia di adresën. Do t’i shkoj në shtëpi të flasim nga afër dhe do t’ju informoj.

Nëse do të më pyeste dikush, nuk do të mund t’i thosha se çfarë konkretisht më shqetësonte aq shumë me vetëvrasjen e Beglerit. Një përgjigje e thjeshtë do të kishte qenë: zhurma që u ngrit në rrjetet sociale dhe manifestimi i sotëm. Është një shqetësim i papërcaktuar, sikur pres zhvillime edhe më të këqija, ndërkohë që nuk mund të shpjegoj me argumente frikën që ndiej.

Meqenëse inercia apo mosveprimi e bën më të theksuar gjendjen e rënduar shpirtërore, i kërkoj Kullës të bëjë një kërkim në internet, mos ndoshta ka qarkulluar diçka e re në lidhje me çështjen apo nëse ka diçka që na ka shpëtuar.

Në fund marr zëvendës drejtorin e përgjithshëm, që të mos e lë në errësirë informative dhe të fillojë ankesat. Informimi rezulton i tepërt, sepse kishte ndërkohë një panoramë të qartë për vetëvrasjen, për postimet në rrjet dhe të tjera lidhur me çështjen. Siç duket, ndalimi i qarkullimit dhe i grumbullimeve në qytet solli si rezultat shtimin e klikimeve dhe krijimin e vështirësive të navigimit në rrjet. Për fat të mirë, i përkas kategorisë së fatlumëve, ngaqë, për shkak të kontakteve të përditshme me nipin tim, nuk më duhen shëtitjet nëpër rrjet.

- A ju shqetëson kjo kthesë që morën ngjarjet duke u nisur nga asgjëja? - më pyet zëvendës drejtori, thua se po i lexonte mendimet e mia.

- Më shqetëson vetëm mundësia e një manifestimi me incidente, që do të ishte qershia mbi tortë. Fola sot në mëngjes me Allamanon dhe i kërkova të më informojë vazhdimisht mbi zhvillimet.

E mbyllim bisedën me një “mbetemi në kontakt”, të shqiptuar nga zëvendës drejtori.

Vendos të bëj një pushim. I them Stelës të më sjellë një kafe, sepse ndërkohë ajo që kisha, ishte bërë akull. Kulla më informon se nga kontrolli në rrjet nuk i rezultoi diçka që, me të vërtetë, do t'ia vlente.

Allamanos më telefonon sapo përfundova kafënë. - Të mora se mos dëshiron të shohësh diçka interesante, - më thotë.

- Kemi incidente? - e pyes i shqetësuar.

- Nëse do të kishim, nuk do të të ftoja të vije. Por kjo situatë ndoshta mund të të interesojë.

- Në rregull, po vij.

- Jam në rrugën “Eollu”, para kishës së “Shën Irinit”.

Porosis Askalidhin të interesohet për një makinë patrulle dhe të më presë në dalje. Preferoj të shkoj i shoqëruar, që, po të ndodhë diçka e paparashikuar, të kem me vete dikë prej ndihmësve të mi.

Qarkullimi i mjeteve është i rrallë dhe nga rruga “Aleksandra” arrijmë te “Shën Irini” në më pak se dhjetë minuta. Allamanosi na pret aty ku na kishte thënë.

- Ç’është ajo që doje të na tregoje?

- Vështroni dyqanet përreth dhe do ta kuptoni. Komentet janë të tepërta, - më përgjigjet.

Bashkë me Askalidhin kalojmë në anën tjetër të rrugës dhe mbetemi pa fjalë. Siç duket, organizatorët e manifestimit ndoqën pikë për pikë sugjerimet e Beglerit.

Një burrë rreth të pesëdhjetave qëndron pa lëvizur në vitrinën e një dyqani rrobash. Në qafë i varet një tabelë prej kartoni, me mbishkrimin: “U shkatërrova ekonomikisht”. Dy dyqane më tutje, në një dyqan këpucësh, një gjashtëdhjetëvjeçar ka mbërthyer vështrimin mbi kalimtarët dhe mban një tabelë me mbishkrimin: “Po vjen Viti i Ri me uri”.

Të njëjtat pamje munda të dalloj gjatë gjithë gjatësisë së rrugës “Eollu”, në të dyja anët e saj, një tabelë për çdo dy a tri dyqane. Një grua pesëdhjetëvjeçare, në një dyqan ku shiten rroba të brendshme, kishte ngjitur në vitrinë fotografi të familjes së saj, me burrin dhe dy fëmijët. Poshtë saj lexohej: “I urituri, nuk është vetëm një, janë shumë”.

- Nuk duhet ta ngarkoni shpirtin me dhimbje, - më thotë Allamanosi, që kishte ardhur me ne. - Kjo panoramë nuk

është vetëm në rrugën “Eollu”, po të njëjtat pamje mund të shihni dhe në rrugën “Mitropoleos”, si dhe në të gjitha rrugët përreth “Monastiraqit”.

- Po tani, çfarë të bëjmë?

- Asgjë. Të paktën deri në këtë moment nuk kemi asnjë shkelje ligji. Ka *lockdown* për dyqanet, por askush nuk i ndalon pronarët e tyre, madje as personelin që të vijë e të bëjë punë brenda në dyqan. Nëse manifestimi do të mbetet në këtë kuadër dhe nuk do të ketë akte dhune nëpër rrugë, atëherë ky do të jetë manifestimi më origjinal i protestës së zhvilluar ndonjëherë.

- Përsëri shkruam historinë, - i them unë.

- Më vjen keq që askush nuk do t'i shohë këto pamje, ngaqë ka ndalim qarkullimi, - është komenti që bën Askalidhi.

- Mos u mërzit, të gjithë do t'i shohin, - i kthehet Allamanosi. - Të gjitha rrjetet sociale, të gjitha emisionet e lajmeve, do të jenë të mbushura me këto fotografi.

U ndamë në të njëjtin vend ku ishim takuar më parë dhe futemi tek automjeti i patrullës.

- Sido që të jetë, na u bë zemra mal, - më thotë Askalidhi.

E quaj të tepërt t'i përgjigjem, sepse edhe unë isha i shokuar nga ato që pashë. Mendoj se Begleri, me aktin e vetëvrasjes, arriti atë që asnjë parti, asnjë sindikatë nuk do ta kishin menduar dhe organizuar.

- Ju kërkoi Vllasopullosi, - më thotë Stela sapo u futa në zyrë.

- Merre menjëherë në telefon.

- Mbesa m'u betua se nuk e postoi ajo letrën e Beglerit dhe se nuk ia dha askujt, madje as mjekut, - më thotë

Vllasopulloshi nga ana tjetër e receptorit. - Madje më tregoi dhe letrën origjinale.

- Po atëherë, si arriti letra në duart e mjekut?

- Më tha se mjeku e fotografoi me celular që të na e dërgonte.

- Atëherë duhet të pyesim mjekun, se mos ndoshta e postoi ai letrën në rrjetet sociale.

- I telefonova ndërkohë edhe atij. Më siguroi se, sapo na e dërgoi neve, e fshiu menjëherë letrën nga celulari i tij.

- Po mbesa e Beglerit, vetëm jeton?

- Jo, jeton me të atin, që është teknik hekurudhash.

Ul receptorin dhe filloj t'i jap shpjegim asaj parandjenje të keqe që po më torturonte. Si arriti letra në duart e atij apo të asaj që e postoi? E konsideroj të pamundur që ta ketë postuar vetë Begleri. Kush është ai që bën postimin e letrës para se të presë damarët e duarve? Thjesht e lë aty pranë vetes. Këtë bëri edhe Begleri. Po si arriti në duart e atij që e postoi? Shpjegimi i vetëm, ndonëse me argumente që mezi qëndrojnë, është që Begleri t'ia ketë diktuar letrën dikujt, dhe ai ta ketë qarkulluar. Po kush është atëherë i dyshuari për këtë postim?

Përpiqem të qetësohem, duke menduar se nuk është gjë e mençur t'u futem ideve të tilla. Këtu nuk kemi të bëjmë me vrasje, por me vetëvrasje. Ajo që më shqetëson më tepër është sukcesi që shënoi manifestimi. Dhe kur pamjet e tij të shfaqen në televizor apo në rrjetet sociale të komunikimit, nuk përjashtohet mundësia që dikush tjetër, i dëshpëruar, të imitojë Beglerin dhe t'i japë fund jetës së vet, me qëllim që të krijohet zhurmë dhe të bëhet temë diskutimi.

Porosis Stelën të thërrasë Velidhin, që punon në Sektorin e Kriminor Elektronik. E konsideroj të domosdoshme të fillojmë një hetim, se mos biem në gjurmët e atij që postoi letrën dhe të zbulojmë se si i ra në dorë.

- Kemi të bëjmë me vrasje? - më pyet Velidhi sapo hyn në zyrën time. - Nuk na mjaftojnë viktimat e pandemisë?

I tregoj të gjithë historinë me vetëvrasjen e Beglerit dhe me manifestimin. Sa më tepër flas, aq më e theksuar është habia që shfaqet në fytyrën e tij.

- Dhe çfarë të shqetëson në këtë çështje? - më pyet kur mbarova së treguari. - Që në momentin që nuk kemi të bëjmë me një vrasje ose me një mashtrim elektronik, gjithçka tjetër nuk ka të bëjë me policinë.

- Nuk e di nëse do të ketë imitues dhe, kryesorja, nëse mbrapa të gjitha këtyre zhvillimeve fshihet ndonjë plan tjetër. Dëshiroj të lokalizojmë marrësin e letrës së Beglerit dhe ta marr në pyetje, qoftë edhe formalisht.

- Ti e kupton se diçka e tillë do të na marrë kohë dhe rezultati nuk është i sigurt, - më shpjegon ai. - Shumë prej atyre që bëjnë postime të tilla fshihen mbrapa pseudonimeve, që janë më se të zakonshme në internet. Nëse kemi të bëjmë me diçka të tillë, nuk e di se sa kohë do të na duhet të lokalizojmë personin në fjalë në *Facebook*.

- E di që ndoshta po të lodh kot, por le të bëjmë një përpjekje, - i them.

Për një moment më kalon nëpër mend që të informoj edhe zëvendës drejtorin e përgjithshëm, por heq dorë menjëherë. Nuk ka arsye të shqetësoj edhe shefat e mi për këtë çështje. Nëse i informoj dhe frika që kam rezulton e kotë, nuk do të pushojnë së foluri mbrapa krahëve.

Deklarata e zëdhënësit të qeverisë pasdite u jep fund diskutimeve për manifestimin: - Nuk kemi asnjë kundërshtim për manifestime proteste që organizohen duke respektuar masat mbrojtëse. Qeveria i mirëkupton plotësisht vështirësitë me të cilat ndeshet tregtia me pakicë për shkak të pandemisë. Respekton protestën e pronarëve të dyqaneve dhe i falënderon që respektuan rregullat e *lockdown*-it.

Pozicionimi zyrtar i qeverisë më qetëson. Bëra mirë që nuk nxitova t’u futem diskutimeve me zëvendësdrejtorin e përgjithshëm. Marr në telefon Velidhin dhe i kërkoj të mos vazhdojë kërkimet në rrjet për lokalizimin e atij që postoi letrën e Beglerit. Nuk ka kuptim ta mendoj kot.

Kur nuk ke se çfarë të bësh, zgjidhja e vetme mbetet të marrësh çantën dhe të kthehesh në shtëpi. Në rastin tim, bëhet fjalë për shtëpinë e vajzës sime.

Për fatin tim të mirë, aty më pret një klimë e qetë. Fani bisedon i buzëqeshur me gruan e vet dhe duket se mendimet u përputhen. Katerina mbështet manifestimin e protestës së pronarëve me dyqanet mbyllur, por edhe mënyrën se si e organizuan. Fani bie dakord me të dhe thotë që nuk ka kundërshtime për protestat, kur ato nuk ndikojnë në shtimin